



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2263/2 prot.

Pogradec, më __, __, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETARE E
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

E nderuar znj. Kryetare !

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:
Miratimin e listës emërore për aplikuesit/familjet e subvencionimit të qerasë në Bashkinë
Pogradec (bashkëngjitur lista).

Me respekt:

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 3

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: —



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____ 2026

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË _____ 2026

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE PËR APLIKUESIT/ FAMILJET
E SUBVENCIONIMIT TË QERASË NË BASHKINË POGRADEC”**

Në mbështetje të Nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” përkatësisht :Neni 3, pika 3 ; Neni 33, pika 1 “Për Subvencionimin e Qerasë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI :**

1. Të miratojë listën e aplikuesve për Subvencionim qeraje sipas programit të Strehimit Social, si me poshtë.

Nr	Emër Mbiemër	Kategoria	Përbërja Familjare	Struktura e Banesës	Njësia Administrative	Vlera mujore e Kontrat qerasë ne Lek/ reja	Afati i Kontratës
1.	Doloreza Muçllari	E Divorcuar	2 Anëtar	1+1	Pogradec	7,200 Lek	7 Muaj
2.	Drita Shuli	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj
3.	Fatmir Oshafi	P.A.K	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
4.	Izmira Muço	Pensionist	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
5.	Klea Guri	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj



6.	Kadri Gjona	Ndihmë ekonomike	3 Anëtar	1+1	Pogradec	7,200 Lek	7 Muaj
7.	Margarita Lame	Rom/Egjiptian	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
8.	Mirjana Aliçkollli	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj
9.	Servet Durbaku	P.A.K	2 Anëtar	1+1	Pogradec	7,200 Lek	7 Muaj
10.	Sami Shuli	Rom/Egjiptian	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
11.	Teuta Mema	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj
12.	Esmeralda Doda	Rom/Egjiptian	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj

**KRYETARE E
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
MANJOLA KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2269/prot.

2

Pogradec, më 21.05, 2026

RELACION

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE PËR APLIKUESIT/ FAMILJET
E SUBVENCIONIMIT TË QERASË NË BASHKINË POGRADEC"**

Në zbatim të ligjit 22/2018 "Per Strehimin Social" VKM-nr.362 dt.29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerases", Ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" si dhe udhëzimeve apo akteve nënligjore të tyre; në vijim të aplikimeve në portalin elektronik e-albania konkretisht rubrika "Kërkesë për të Përfitur nga Programet e Strehimit Social", pasi u regjistruan dhe protokolluan të gjitha aplikimet për subvencionim qeraje konkretisht **33 kërkesa**, nga ku më pas u vijua nga sektori i strehimit për trajtimin e çdo kërkesë konform ligjit;

- Sipas fondit të miratuar për sektorin e strehimit me VKB në buxhetin vjetor nga Drejtoria e Financave në bashki; u regjistruan dhe u hap dosje për çdo kërkesë,
- U plotësua dokumentacioni i nevojshëm për çdo rast në mënyrë që çdo dosje të ishte e rregullt dhe korrekte ligjërisht (me të gjitha vërtetimet),
- Mbasi u bë seleksionimi dhe intervista (pritje në zyrën e strehimit) u pikëzuan sipas kriterëve ligjore dhe VKB -së bashkëngjitur,
- Sipas komisionit të strehimit u mbajt procesverbali (bashkëngjitur) për konfirmimin e të gjitha familjeve të përzgjedhura (konkretisht **12 familje** përfituese),
- Për **21 familjet** apo aplikimet e tjera (pas verifikimit dhe kontaktimit me ato për plotësim apo mangësi dokumentacioni si dhe rezultat i mosprezencës së tyre nga kontakti), u arkivuan për tu trajtuar në thirrjet në vijim,
- Afati i kontratës dhe vlera, janë vënë sipas VKB-ve përkatëse të miratuara më parë (sipas fondit që ka Dr.Financës në Bashki dhe sipas tipologjisë së apartamentit)

Nga sa më sipër bashkëngjitur relacionit, po ju përcjellim listën emërore me familjet përfituese për subvencionimin e qerases në tregun e lirë për familjet në nevojë, duke specifikuar çdo rast:

- Familja e **znj.Doloreza Muçllari** (familje e kategorisë e divorcuar me fëmijë të mitur, e pastrehë, e papunë, në kushte jo-të mira ekonomike)
- Familja e **znj.Drita Shuli** (familje e kategorisë trajtim me ndihmë ekonomike me shumë anëtarë, me të ardhura të ulëta, e pastrehë).



3. Familja e z.Fatmir Oshafi (person me kategori P.A.K, i pastrehë, me të ardhura të ulëta dhe në vështirësi ekonomike)
4. Familja e znj.Izmira Muço (pensioniste e vetmuar, e pastrehë, në kushte të vështira ekonomike dhe të ardhura shumë të ulëta).
5. Familja e znj.Klea Guri (familje e kategorisë emigrant të kthyer , me ndihmë ekonomike, të pa punë dhe të ardhura të ulëta).
6. Familja e z.Kadri Gjona (familje me ndihmë ekonomike, kategorizohet përfitues për arsye se ka mbetur i pastrehë si shkak i shembjes së banesës nga shkaqe natyrore në fshatin Diaktesh Nja. Velçan Pogradec bashkëlidhur procesverballi).
7. Familja e znj.Margarita-Lame (familje e kategorisë Rom/Egjiptian si dhe pensioniste e vetmuar me të ardhura të ulëta).
8. Familja e znj.Mirjana Aliçkollli (familje e kategorisë trajtim me ndihmë ekonomike me shumë anëtarë, e pastrehë dhe me të ardhura shumë të ulëta ekonomike, të papunë).
9. Familja e z.Servet Durbaku (familje e kategorisë P.A.K, pensionistë të vetmuar, kategorizohet përfitues për arsye e mbetur e pastrehë si shkak i shembjes së banesës në fshatin Rrodokal Sipër Nja.Rroptisht Pogradec sipas procesverbalit, zhvendosur m qera).
10. Familja e z.Sami Shuli (familje kategori Rom/Egjiptian, i pastrehë me ndihmë ekonomike, i vetmuar me të ardhura të ulëta).
11. Familja e znj.Teuta Mema (familje e kategorisë me trajtim me ndihmë ekonomike me shumë anëtarë, e pastrehë dhe me të ardhura shumë të ulëta ekonomike si dhe të papunë).
12. Familja e znj.Esmeralda Doda (familje e kategorisë Rom/Egjiptian, me 4 anëtarë, në kushte të vështira ekonomike me të ardhura të ulëta, e pastrehë me qera).

Spektori i Strehimit pranë Drejorisë së Emergjencave, Strehimit, Pronësisë dhe Bashkëpronësisë, Administrimit të Tokës dhe Supervizimit të Shërbimeve në Bashkinë Pogradec, *kërkon* miratimin e listës emerore të aplikuesve/familjeve per programin e subvencionimit të bonusit të qerasë në tregun e lirë, pasi qytetaret që kanë aplikuar nuk kanë gjetur një strehim emerore *përfundimtar (bashkangjitur relacionit, lista emerore)*.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin presim konfirmimin tuaj!

Konceptoi: U.SIMAKU D.DRAGOJ 
 Pranoi: E.DULELLARI 
 Miratoi: N.TORRA 
 Konfirmoi: P.ZIKO 

KRYETAR
Dr. XHAKOLLI


Nr	Emër /Biemër	Kategoria	Përbërja Familjare	Struktura e Banesës	Njësia Administrative	Vlera mujiore e Kontrat qerasë ne Lek/ reja	Afati i Kontratës
1.	Doloreza Muçllari	E Divorcuar	2 Anëtar	1+1	Pogradec	7,200 Lek	7 Muaj
2.	Drita Shuli	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj
3.	Fatmir Oshafi	P.A.K	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
4.	Izmira Muço	Pensionist	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
5.	Klea Guri	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj
6.	Kadri Gjona	Ndihmë ekonomike	3 Anëtar	1+1	Pogradec	7,200 Lek	7 Muaj
7.	Margarita Lame	Rom/Egjiptian	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
8.	Mirjana Aliçkollli	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj
9.	Servet Durbaku	P.A.K	2 Anëtar	1+1	Pogradec	7,200 Lek	7 Muaj
10.	Sami Shuli	Rom/Egjiptian	1 Anëtar	Garsoniere	Pogradec	4,200 Lek	7 Muaj
11.	Teuta Mema	Ndihmë ekonomike	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj
12.	Esmeralda Doda	Rom/Egjiptian	4 Anëtar	2+1	Pogradec	9,000 Lek	7 Muaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 209 Prot

Pogradec, më 21.05.2026

2

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN

**"PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË NË TREGUN E LIRË PËR
FAMILJET NË NEVOJË NË BASHKINË POGRADEC"**

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar:
"Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Po kështu, në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton:
"Akt me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore".

Më tej, ky ligj në Nenin 8, shkronja "a" përcakton se: *"është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore."*

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të



miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Bazuar në Ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

"*Akt normativ nënligjor*" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Ky projekt-vendim nuk ka karakter normativ, pasi nuk vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte për një numër të pacaktuar subjektësh, por trajton marrëdhënie konkrete juridike ndërmjet bashkisë dhe subjekteve përkatëse.

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedurave Administrative jep këtë përkufizim për "Aktin administrativ":

- a) "*Akti administrativ individual*" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektësh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
- b) "*Akti administrativ kolektiv*" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektësh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim, i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 "b", të Ligjit 44/2015 të "Kodit të Procedurës Administrative", pra përbën një akt administrativ kolektiv me disa përfitues të përcaktuar, pasi i drejtohet një liste konkrete të familjeve përfituese, duke përcaktuar masën e përfitimit, afatin dhe kushtet përkatëse të subvencionimit.

Po kështu, miratimi i këtij projekt-vendimi krijon mundësinë e përfitimit të subvencionimit të qirasë, nga familjet e përzgjedhura sipas kriterëve ligjore, si dhe krijon bazën financiare dhe administrative për zbatimin e programit të strehimit social në Bashkinë Pogradec.

Perfundimisht konkludojmë se: Projekt-vendimi paraqitet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë.

Konceptoi: N.NAUN

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË
ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE
SEKTORI I STREHIMIT, SHPRONËSIMEVE DHE BASHKËPRONËSISË

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË STREHIMIT

Nr. 01 / Datë: 30 / 04 / 2026

Në POGRADËC (vendndodhja), më datë 30 / 04 / 2026, u zhvillua mbledhja e Komisionit të Strehimit, i ngritur pranë BASHKIA (emri i institucionit/bashkisë), për shqyrtimin e aplikimeve për përfitimin e subvencionimit të bonusit të qerasë në tregun e lirë, për familjet në nevojë.

1. PËRBËRJA E KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë:

1. DRITAN BALLIU
2. SHPËTIM DUTE
3. VJOLLCA PLLANA
4. IVAWA LLAKMANI
5. ARDËR MALE
6. PASKALINO ZIKO
7. NEXHMI TORRA

2. RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i aplikimeve të paraqitura nga familjet në nevojë për përfitimin e bonusit të qerasë.
2. Verifikimi i dokumentacionit dhe plotësimi i kritereve ligjore.
3. Vlerësimi dhe pikëzimi sipas sistemit në fuqi.
4. Hartimi i listës përfituese.

3. SHQYRTIMI I APLIKIMEVE

Komisioni shqyrtoi gjithsej 33 aplikime të paraqitura brenda afatit ligjor.

Pas verifikimit të dokumentacionit rezultoi se:

- 12 aplikime janë të rregullta dhe të plota;

- 21 aplikime janë të paplota / të shkualifikuara për shkak të:
 - o mungesë dokumentacioni;
 - o mosplotësim kriteresh;
 - o deklarime të pasakta.



4. VLERËSIMI DHE PIKËZIMI

Komisioni bëri vlerësimin e aplikantëve bazuar në kriteret ligjore në fuqi, si:

- Të ardhurat familjare;
- Numri i anëtarëve të familjes;
- Kushtet e banimit;
- Statusi social (persona me aftësi të kufizuar, familje njëprindërore, etj.);
- Faktorë të tjerë sipas legjislacionit përkatës.

Tabela e pikëzimit bashkëlidhet si **Aneks 1** i këtij procesverballi.

5. VENDIMI I KOMISIONIT

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit, Komisioni vendosi:

- Të miratojë listën përfituese me 12 familje që plotësojnë kriteret për subvencionimin e bonusit të qerasë;
- Të refuzojë 6 aplikime për shkak të mosplotësimit të kriterëve;
- Lista përfundimtare bashkëlidhet si **Aneks 2** dhe do të publikohet sipas procedurave në fuqi.

6. ANKIMET

Aplikantët kanë të drejtë ankimi brenda 10 ditëve nga data e publikimit të listës, pranë BASHKISË (institucioni përkatës).

7. MBYLLJA E MBLEDHJES

Mbledhja u mbyll në orën 12:00

Ky procesverbal u hartua dhe u nënshkrua nga të gjithë anëtarët e komisionit.

NËNSHKRIMET

BRITAN BALLIU 

SHPETIM DUTË 

Arbër Hale 

Nexhë Tomaj 

Ymeri Ahmeti 

Paskalino Ziko 

Triona Llekmonu 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2276/Prot.
13

Pogradec, më 30.05.2024

VENDIM

NR. 63, DATË 28.05.2024

"PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI STREHIMIT SOCIAL "SUBVENCIONIMIT TË QIRASË".

mbeshtetje të Ligjit Nr. 22/2018 "PËR STREHIMIN SOCIAL" përkatësisht (Neni 3, pika 3 ; Neni 13,14,15,16, Neni 33,34,35 "SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

Miratimin për sistemin e pikëzimit mbi projektin "SUBVENCIONIMIT TË QIRASË".

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT "SUBVENCIONI I QIRASË"

NR.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi	25
ii	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.	6
iii	Banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë.	5
iv	Banojnë në banesa të mbipopulluara sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	4
v	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike.	5
B	KUSHTET FAMILJARE	
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat aëna.	25
ii	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të kujdesjes shoqërore.	6
iii	Familjet me më shumë se 4 (katër) fëmijë.	5
iv	Familjet e reja, ku moshë e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	6
v	Të rinj, që në momentin e aplikimit kanë moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	4
	KUSHTET SOCIALE	
	Personat më aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie.	25





iii	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirinimit të banesave ish-pronarëve.	2
iv	Emigrantë të rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuessit, refugjatët spo personat me mbrojtje plotësuese.	2
v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	2
vi, vii,viii	Punonjës i repartëve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH. Punonjësit e repartit RENEA. Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.	2
ix	Viktimat e trafikimit / Viktimat e mundshme të trafikimit.	2
x	Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian.	4
xi	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit.	2
xii	Vajzat Nëna.	2
xiii	Individët që i përkesin komunitetit LOBTI, të cilët janë viktime për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.	1
D	KUSHTET EKONOMIKE	25
i	Të ardhurat nën 70% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	15
ii	Të ardhura 70-100% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	10
iii	Të ardhura 100-120% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	0
	TOTALI PIKË	100

KRYETARË E KËSHILLIT

Marjola KAMOLLA



ratuar me 23 vota

ta Pro 23

ta Kundër 0

q Abstenitu 0

rdhur më datë 30.05.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 840/4 Prot.

Pogradec, më 26.02.2026

VENDIM

NR. 23, DATË 25.02.2026

"PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË"

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.05.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 38 të Ligjit 22/2018 "Për Strehimin social" i ndryshuar, në pika 4 e VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qerasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr.459 datë 03.07.2019 Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qerasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimit dhe bashkëpunimit ndërmjet-njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKB mbi miratimin "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026", Udhëzimit Nr. 31 datë 18.11.2019 "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ; paraqesim për miratim vlerën maksimale të subvencionimit të qerasë dhe vlerën mesatare të qerasë në tregun e lirë për programin "Subvencionimi i Qerasë" që zbatohet nga Bashkia Pogradec dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1.Të miratojë nivelin e qerasë mesatare në tregun e lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Pogradec, sipas tabelës bashkëngjitur.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen ; Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria Emergjencave, Strehimit, Pronësisë dhe Bashkëpronësisë, Administrimit të tokës dhe supervizimit të shërbimeve Bashkia Pogradec .





Tabela.1

Niveli mesatar i qerasë në tregun e lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2025.

Nr	Emërtimi, tip i apartamentit	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar
1	Ap. Garsoniere	muaj	1	7,000 lek
2	Ap. 1+1	muaj	1	12,000 lek
3	Ap. 2+1	muaj	1	15,000 lek
4	Ap. 3+1	muaj	1	20,000 lek

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMQELI



1. Miratuar me 22 vota

2. Vota Pro 22

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenimi 0

5. Zbardhur më datë 25.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3787/5 Prot.

Pogradec, më 29 . 09 .2023

VENDIM

NR. 104, DATE 27 . 09 .2023

**"PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR VITIN USHTRIMOR 2023-2024 SIPAS
LIGJIT NR. 22/2018 ME DISA NDRYSHIME ME LIGJIN NR. 48/2023 DATE 22.06.2023"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

KËSHILLI BASHKIAK

1. Pranë Bashkisë së Pogradecit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i Strehimit përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1) Nënkyetar i Bashkisë Pogradec	(Paskalino Ziko)	Kryetar
2) Drejtor i Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokave Bujqësore në Njësitë Administrative	(Besmira Niko)	Anëtar
3) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale	(Ivana Llakmani)	Anëtar
4) Përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve	(Dritan Balliu)	Anëtar
5) Përfaqësues i Komuniteteve të Interesuara (Rome/Egjyptiane)	(Shpëtim Dute)	Anëtar
6) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Arbër Male)	Anëtar
7) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Vjollca Pllaha)	Anëtar
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (Sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore").

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

533
P-5
28.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E STREHIMIT

Nr. 628 / Prot.
2

Tiranë, më 23 / 01 / 2026

Lënda: Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026

BASHKISË POGRADEL

Në zbatim të Ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi, ju bëjmë me dije mbi hapjen e thirrjes për projekte të reja për programet e strehimit për vitin 2026; mbi Termat e Referencës, afatet, Dosjen/ Formularët e Aplikimit dhe kushtet për përfitimin e fondeve buxhetore.

Dosja e Aplikimit, dokumentacioni që do të shoqërojë formatin e aplikimit, kriteret skualifikuese, tabelat përkatëse, sistemi i pikëzimit dhe kufijtë e financimit/ bashkëfinancimit jepen në Lidhjen nr. 1 dhe Lidhjen nr. 2 (bashkëlidhur).

Kërkesa për financim duhet të dërgohet pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, brenda datës 16/02 / 2026, e shoqëruar me Dosjen e Aplikimit (sipas Lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2).

Të gjitha tabelat përmbledhëse të dërgohen edhe në soft copy, në formatin excel, në adresën e email-it: drejtoria.strehimit@ekonomia.gov.al.

Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 do të publikohen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Duke ju falënderuar,

MINISTËR
Delina Ibrahimaj
REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
TIRANË



Tabela nr. 3, Kategoritë e familjeve përfituese për subvencionimin e qirasë (shprehur në nr. familjesh)¹

Nr.	Kategoria përfituese sipas nenit 16 të ligjit 22/2018, i ndryshuar	Numri i familjeve përfituese, sipas kategorive
1	PAK	
2	Jetimët	
3	Të rinj me moshë jo më shumë se 40 vjeç	
4	Familje e re, mosha e anëtarit më të madh jo më shumë se 40 vjeç	
5	Familjet me një prind	
6	Familjet me më shumë se 4 fëmijë	
7	Familjet me fëmijë nën moshën 18 vjeç	
8	Të moshuarit	
9	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve	
10	Emigrantet e rikthyer	
	Punëtorët emigrant	
11	Azilkërkuessit	
12	Familjet e policëve të rënë në detyrë	
13	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejt (FNSH)	
14	Punonjësit e repartit RENEA	
15	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	
16	Viktima të dhunës në familje	
17	Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	
18	Familje Rome	
19	Gra kryefamiljare	
20	Familje Egjiptiane	
21	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit	
22	Vajzat nëna	
23	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI	
24	Tjetër (specifiko)	
	Gjithsej (nr. total familje aplikuese)²	
	³Gjithsej nr. total i fëmijëve përfitues nën moshën 18 vjeç, të të gjitha kategorive të mësipërme	

¹ Një familje mund të bëjë pjesë në më shumë se një kategori

² Numri i familjeve aplikuese nuk është shumatorë e kategorive

³ Numri i të gjithë fëmijëve, të familjeve që do të trajtohen me programin përkatës

Tabela nr. 5 "Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki, për vitin 2024"



Nr	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Të ardhurat vjetore për frymë, viti 2024 (lekë)
1	Bashkia Belsh	2,745
2	Bashkia Berat	5,281
3	Bashkia Bulqize	2,172
4	Bashkia Cerrik	3,618
5	Bashkia Delvine	3,918
6	Bashkia Devoll	4,068
7	Bashkia Diber	2,087
8	Bashkia Divjake	4,024
9	Bashkia Dropull i Poshtem	4,171
10	Bashkia Durres	9,734
11	Bashkia Elbasan	7,585
12	Bashkia Fier	5,373
13	Bashkia Finiq	5,085
14	Bashkia Fushe-Arrez	5,015
15	Bashkia Gjirokaster	6,722
16	Bashkia Gramsh	4,921
17	Bashkia Has	1,200
18	Bashkia Himare	42,967
19	Bashkia Kamez	21,489
20	Bashkia Kavaja	20,972
21	Bashkia Kelcyre	1,426
22	Bashkia Klos	3,078
23	Bashkia Kolonje	4,746
24	Bashkia Konispol	4,708
25	Bashkia Korce	8,394
26	Bashkia Kruje	7,490
27	Bashkia Kucove	5,000
28	Bashkia Kukes	3,449
29	Bashkia Kurbin	1,545
30	Bashkia Lezhe	13,237
31	Bashkia Libohove	2,730
32	Bashkia Librazhd	4,522
33	Bashkia Lushnje	5,067
34	Bashkia Malesi e Madhe	2,612
35	Bashkia Maliq	3,316
36	Bashkia Mallakaster	6,503
37	Bashkia Mat	5,912



38	Bashkia Memaliaj	1,937
39	Bashkia Mirdite	2,886
40	Bashkia Patos	7,920
41	Bashkia Peqin	2,581
42	Bashkia Permet	4,172
43	Bashkia Pogradec	6,946
44	Bashkia Polican	7,737
45	Bashkia Prenjas	3,899
46	Bashkia Puke	3,753
47	Bashkia Pustec	1,164
48	Bashkia Rogozhine	6,635
49	Bashkia Roskovec	9,873
50	Bashkia Sarande	22,252
51	Bashkia Selenice	5,708
52	Bashkia Shijak	6,037
53	Bashkia Shkoder	7,136
54	Bashkia Skrapar	4,333
55	Bashkia Tepelene	7,022
56	Bashkia Tirana	37,513
57	Bashkia Tropoje	2,513
58	Bashkia Ura Vajgurore	5,145
59	Bashkia Vau-Dejes	3,804
60	Bashkia Vlore	10,317
61	Bashkia Vore	18,104

Tabela nr. 6, Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë sipas Tabelës nr. 5 "Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki, për vitin 2024"

Nr.	Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (lekë)	Përqindja maksimale e financimit nga buxheti i shtetit
1	me të ulëta se 2,000	deri 100%
2	2,001-4,000	deri 80%
3	4,001-6,000	deri 70%
4	6,001-8,000	deri 60%
5	mbi 8,001	deri 50%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 14071 Prot
/12

Datë 04.05 2026

VENDIM

NR. 121, DATË 04.05 .2026

PËR

EMËRIM NËPUNËSI

Në mbështetje të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, Kreu IV "Pranimi në Shërbimin Civil, neni 23, VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar, Kreu III "Ngritja në detyrë", Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 20, datë 22.01.2026 " Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, njësi administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2026", Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 128 datë 22.12.2025 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026", në përfundim të procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë,

VENDOSËM:

1. Të emërojmë nga lista fituese, **Z. Nexhmi Torra** në pozicionin "**Drejtor**" në Drejtorinë e Emergjencave, Strehimit, Pronësisë dhe Bashkëpronësisë, Administrimit të Tokës dhe Supervizimit të Shërbimeve, Kategoria e pagës II-2.
2. Kandidati fitues është nëpunës civil i konfirmuar.
3. Marrëdhëniet financiare në këtë pozicion fillojnë në datë 04.05 .2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

LAURA ELMASLLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



Nr. 5054 Prot.

Pogradec, më 21.12.2023

URDHËR

Nr. 686, DATË 21.12.2023

**PËR AUTORIZIMIN E NËPUNËSIT PUBLIK TË BASHKISË POGRADEC PËR
NËNSHKRIMIN E KONTRATAVE NË EMËR TË BASHKISË ME PËRFITUESIT E
SUBVENCIONIMIT TË BONUSIT TË QERASË.**

Duke u bazuar tek Ligji nr.22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar me Ligjin nr.48/2023 konkretisht neni 31 pika 9/1 , neni 2, pika 45 shkronja c dhe ç

URDHËROJ:

Autorizimin e nëpunësit z.Erald Balliu me detyrë si Kordinator i Zyrës së Strehimit për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave me qytetarët pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulta sipas përcaktimeve të shkronjave c dhe ç të pikës 45 te neni 2 të këtij ligji, që trajtohen me subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nënshkruajnë kontratën pa asnjë tarifë me kryetarin/en e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose personin e autorizuar prej tij/saj, ose para punonjësit i cili nënshkruan si i pranishëm. Kontrata regjistrohet në një rubrikë të posaçme në sistemin e strehimit të ngritur në portalin qeveritar "e-Albania" sipas neneve 72 dhe 73 të këtij ligji ku pasqyrohen të dhënat për: a) palët kontraktuese; b) kohëzgjatjen e kontratës; c) pasurinë, si: vendndodhja, sipërfaqja, tipologjia e njësisë së banimit dhe kushtet fizike të njësisë së banimit; ç) masa e qirasë mujore; d) të ardhurat e përfituesit të subvencionimit të qirasë; dh) subvencionimi mujor që përfiton individi/familja".

1. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet personi i mësipërm.
2. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: K.Liçkollari

Miratoi: B.Niko

